


Bibël për fëmijët paraqet



Një Kohë e Tmerrshme për Jezusin



Shkruar nga: Edward Hughes
Ilustruar nga: Byron Unger; Lazarus

Përkthyer nga: Arianit Iljazi
Adaptuar nga: M. Maillot; Sarah S.

Tregimi 38 nga 60
www.M1914.org

Bible for Children, PO Box 3, Winnipeg, MB R3C 2G1 Canada

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori, nëse nuk do ta shitni.

Shqip

Albanian

Kur Jezusi
u pagëzua,
Perëndia foli.
Ai tha, "Ky është
Biri Im i dashur.
Në Të, Unë jam
kënaqur". Fryma
e Shenjtë e
Perëndisë
zbriti mbi
Jezusin si
një pëllumb.



Shpejt pas kësaj,
Fryma e Shenjtë e
Perëndisë e drejtoi
Jezusin në një vend
të shkretë. Jezusi
ishite vetëm.



Jezusi agjëroi për dyzet ditë. Kjo do të thotë që Ai nuk hëngri asnjë ushqim. Atë e mori shumë uria.



Bibla thotë se kafshët e egra ishin gjithashtu atje.



Satani erdhi të tundojë Jezusin. Kohë më parë ai kishte tunduar Adamin dhe Evën për të mos iu bindur Perëndisë në Kopshtin e Edenit. Tani, Jezusi do të provohej.



Satani mund të provonte të tundonte madje edhe Birin e Perëndisë, Jezusin.




"Nëse Ti je Biri i Perëndisë", tha djalli, "Ktheji këta gurë në bukë". Ai e dinte që Jezusi ishte i uritur.




Ai e dinte se Biri i Perëndisë mund ti kthente gurët në bukë. A do ti bindej Jezusi djallit?




Jo! Jezusi nuk i bind djallit. Përkundrazi, Ai iu përgjigj nga Fjala e Perëndisë.



"Njeriu nuk do të jetojë vetëm me bukë, por nga çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë".




Pastaj Satani e çoi Jezusin në qytetin e madh të Jerusalemit, në tempullin e shenjtë ku njerëzit adhuronin Perëndinë. Çfarë do të bënte djalli më pas.



"Nëse Ti je Biri i Perëndisë, hidhu poshtë", tha djalli. "Fjala e Tij thotë se engjëjt e Tij do të të shpëtojnë".




"Jo"! U përgjigj Jezusi. "Është shkruar gjithashtu... 'Nuk do ta tundosh ZOTIN, Perëndinë tënd'".



Djalli e provoi sërish. Ai e nxorri Jezusin jashtë qytetit në një majë shumë të lartë mali.



Duke i treguar Jezusit të gjithë lavdinë e çdo mbretërie tokësore, djalli tha, "Unë do ta jap të gjithën ty, nëse bie përmbys dhe më adhuron".



15

"Largohu prej meje, Satan", Urdhëroi Jezusi. "Eshtë shkruar... 'Ti do të adhurosh ZOTIN, Perëndinë tënd dhe vetëm Atij do ti shërbesh".



16

Djali e la Jezusin për pak. Atëherë diçka e mrekullueshme ndodhi.



17

Perëndia dërgoi engjëjt ta ngushëllonin dhe të kujdeseshin për Jezusin, Birin e Tij - i Cili nuk iu bind djallit.



18

Një Kohë e Tmerrshme për Jezusin
Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla
e marrë nga
Mateut 4, Llukës 4

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u jep mendje njerëzve të thjeshtë."
Psalmet 119:130

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan mëkate. Denimi për mëkatin është vdekja.

Perëndia na don neve aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij, Jezusin, që të vdes në Kryq dhe të paguaj dënimin tonë. Pastaj Jezusi u ringjall dhe u ngrit lartë në Qiell.

Nëse ti do që të pendohesh, thuaja këtë Perëndisë:
Perëndi i dashur, unë besoj në Jezusin që vdiq për mua dhe jeton. Të lutem eja në jetën time dhe m'i fal mëkatet, në mënyrë që të kem jetën e re. Dhe që të jem me Ty përgjithmonë. Më ndihmo që të jetoj për Ty si fëmija i Yt. Amen. Gjoni 3:16

Lexo Biblën dhe fol me Perëndinë çdo ditë!

